



STRATEGJITË E OFRIMIT TË SHERBIMIT NDAJ PUBLIKUT

Ka disa rregulla që duhet të respektohen nga nëpunësi i gjendjes civile në ofrimin e shërbimeve ndaj publikut:

- a) Dëgjoni me vëmendje dhe paraqisni pyetje.** Eshtë e domosdoshme të kuptosh çfarë kërkojnë apo për çfarë kanë nevojë qytetarët.
- b) Jini i duruar.** Shumë qytetarë nuk janë të familjarizuar me llojin e shërbimeve të ofruar nga gjendja civile dhe, për këtë, paraqitja përpara Zyrave të Gjendjes Civile, mund të jetë shumë stresuese dhe mund t'i bëjë ata të ndjehen të ndrojtur.
- c) Nuk ka rëndësi vetëm ajo çfarë thoni, por edhe mënyra se si e thoni atë.** Është gjithnjë shumë e rëndësishme të kujtojmë se toni i zërit dhe gjuha e xhesteve flasin me zë më të lartë se sa fjalët dhe ato kanë ndikim të madh në mënyrën se si njerëzit i kuptojnë përpjekjet për të ofruar shërbim nga gjendja civile.
- d) Ofrojeni shërbimin e kërkuar publikut brenda një kohe të arsyeshme.** Shërbimi që duhet t'i ofrohet qytetarit duhet të jetë sa më i shpejtë të jetë e mundur, por pa shkelur parimet e një shërbimi efektiv dhe të saktë.
- e) Bëni maksimumin për t'i ndihmuar qytetarët.** Disa probleme mund të zgjidhen lehtë, disa të tjera kërkojnë më shumë mund. Sidoqoftë, qytetarët duhet ta ndjejnë që atyre po iu kushtohet vëmendja dhe koha e duhur dhe që po bëhet maksimumi i mundshëm për zgjidhejn e problemit të tyre.
- f) Shërbimi dhe personeli të jetë të gatshëm dhe të arritshëm.** Kjo do të thotë se nëpunësi i gjendjes civile, madje deri tek drejtiesit e tyre duhet të jenë gjithmonë të gatshëm dhe të arritshëm për publikun, në mënyrë që publiku të përfundojë me sukses punët për të cilat është i interesuar.
- g) Trajtoni njerezit në mënyrë të barabartë.** Qytetarët duhet ti trajtoni si të barabartë në zbatimin e rregullave. Nëpunësi i gjendjes civile nuk duhet të ofrojë shërbim të diferencuar qytetarëve që paraqiten pranë Zyrave të Gjendjes Civile.
- h) Shpjegoni arsyet.** Nëse nëpunësi i gjendjes civile, nuk mund të ofrojë informacionin e kërkuar, ata duhet të shpjegojnë arsyet, duke u përpjekur të rrisin besimin e publikut për ndershmërinë, paansh-mërinë dhe efektivitetin e shërbimit të gjendjes civile
- i) Ruani konfidencialitetin e informacionit.** Nëpunësi i gjendjes civile duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit që ka në zotërim, por pa cënuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 8503, date 30.6.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare".



UDHËZUES PËR NËPUNËSIT E GJENDJES CIVILE

Gjendja civile është tërësia e të dhënave personale, që vërteton lindjen, ekzistencën, individualitetin e shtetasve, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Lindja

Dokumentet që duhet të paraqiten për regjistrimin e lindjes janë:

1. certifikata e asistencës së lindjes e lëshuar nga:

institucioni ku ka ndodhur lindja

mjeku i pranishëm në lindjet jashtë institucionit

mjeku që ka kontaktuar nënën dhe fëmijën pas lindjes

2. procesverbal i hartuar në kohën e lindjes nga përgjegjësi ose kapiteni i trenit, i anijes ose i avionit në udhëtim, komandanti i burgut ose i repartit ushtarak, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit.

3. vendimi gjyqësor i formës së prerë për vërtetimin e faktit të lindjes.

Personat që mund të regjistrojnë lindjen janë:

1. prindërit;

2. pjesëtarët madhorë të familjes, përfaqësuesit ligjorë ose kujdestarët;

3. personat që kanë të drejtë të vërtetojnë lindjen (në mungesë të personave të tjerë)

Vdekja

Dokumentet që duhet të paraqiten për deklarimin e vdekjes janë:

1. raport mjekësor

2. vendimi gjyqësor i formës së prerë për vërtetimin e faktit të vdekjes

Personat që mund të deklarojnë vdekjen janë:

1. çdo pjesëtar i familjes ose i afërt

2. në mungesë të tyre ose për personat pa njeri, nga i ngarkuari i posaçëm i bashkisë ose komunës ku ka banuar ose është gjetur i vdekuri.

Martesa

Akti i martesës është një procesverbal i mbajtur nga nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, në të cilin pasqyrohet marrëveshja e bashkëshortëve të ardhshëm e lidhur në prani të nëpunësit të gjendjes civile, sipas kërkesave të Kodit të Familjes.

Kushtet për lidhjen e martesës janë:

1. mosha mbi 18 vjeç e burrit dhe e gruas

2. shpallja publike e martesës

3. mungesa e pengesave ligjore për lidhjen e martesës (nenet 9-14 të Kodit të Familjes)